



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:248910
Datë: 30.10.2024
Numri i dokumentit: 06373281

Kom.Dh.Shk.II.nr.1957/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkalles se Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Krenar Berisha, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - konfliktin administrativ sipas propozuesit – paditësit “Kastrioti” shpk me seli ne Prishtinë, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson N.B., kundër kundërshtares se propozimit - të paditurës Komuna e Prishtinës , me bazë juridike për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit - propozuesit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Pare - Departamenti për çështje administrative KA.nr.453/24, të datës 16.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesit – paditësit “Kastrioti” shpk me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Pare - Departamenti për Çështje administrative KA.nr.453/24, të datës 16.09.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Administrative, është hedhe poshtë propozimi i paditësit – propozuesit “Kastrioti” shpk me seli ne Prishtinë, për shtyrjen e njoftimit publik për paisje për ushtrimin e veprimtarisë afariste për organizimin e transportit te udhëtarëve sipas thirrjes për shprehje te interesit te datës 04.07.2024 – 24.07.2024, si e papranueshme.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Administrative ka ushtruar ankesë i autorizuari paditëses – propozueses për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e

shkalles se dyte aktvendimin e kontestuar ta ndryshon dhe të aprovojë kërkesën e paditëses – propozueses për lejimin e masës së propozuar apo ta prish aktvendimin e goditur dhe lëndën ta kthejë gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

Kolegji i Gjykatës Komerciale e Kosoves -Dhoma e shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së propozuesit – paditëses, kolegji i kësaj gjykate, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrje e njoftimit publik për paisje për ushtrimin e veprimtarisë afariste për organizimin e transportit të udhëtarëve sipas thirrjes për shprehje të interesit të datës 04.07.2024 – 24.07.2024, ka gjetur se propozimi i tillë është i papranueshëm, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 9, 13, 14 dhe 34 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA).

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një konkludim të tillë të gjykatës së shkallës së parë ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret rezulton se akti i atakuar nuk përben akt përfundimtar administrativ në kuptim të neni 9 të LKA, pasi që paditësi fillimisht është dashtë të i drejtohet Komisionit për Shqyrtim të ankesave dhe vetëm pas pranimit të vendimit përfundimtar, të mund të propozoj shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të propozueses – paditëses, në ankesë të cekura më lartë ndaj aktvendimit të shkallës së parë, kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale dhe nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e refuzimit të propozimit për caktimin e masës së përkohshme dhe shtyrjes së ekzekutimit të vendimit dhe se pretendimet ankimore janë të pa ndikim për vendosje në mënyrë tjetër, andaj ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES
Dhoma e Shkalles se Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1957/2024, me datë 28.10.2024

Kryetari i kolegjit- Gjyqtari
Faton Bajrami , Dv.